



АБЕР 2015

Здружение за рурален развој Локална Акциона Група АБЕР 2015

PËRMIRËSIMI I KONKURENCËS SË PRODHIMTARISË LOKALE DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Dokument i shkurtë për politika publike të Shoqatës për Zhvillim Rural "ABER 2015", f. Staro Nagoriçane

HYRJE

Zhvillimi i pabarabartë ekonomik nëpër territorin e Republikës së Maqedonisë shënon një trend të vazhdueshëm të rritjes. Nëse krahasohen rajonet e planifikimit, rajoni i Shkupit karakterizohet si më i zhvilluar, ndërsa ato Lindor dhe Verilindor konsiderohen një prej më pak të zhvilluar. Kjo gjendje tregon për ndryshimin urgjent dhe të nevojshëm të politikave për zhvillim rajonal dhe rural.

Grupi Lokal i Aksionit (GLA) "ABER 2015" punon për zhvillimin ekonomik të një pjese të Rajonit Verilindor të Planifikimit (mikro-rajonit Likovë, Kumanovë dhe Staro Nagoriçanë). Organizimi në formë në territorin e GLA-së, në përputhje me parimet LEADER, duhet të rrit potencialin për zhvillim, veçanërisht shoqërimin dhe koordinimin e resurseve lokale. Fuqia ekonomike dhe përparësia konkurruese e secilës komunë, hapja e vendeve të punës mundëson përmirësim të kushteve për rritje ekonomike dhe zhvillim të gjithë GLA-së dhe përmirësim të kushteve për jetë të qytetarëve që jetojnë në atë. Ky shoqërim në nivel të territorit të GLA-së mund të ngrit planifikimin dhe veprimin e përbashkët në një nivel të lartë dhe të hap një perspektivë të re për krijimin e klimës për zhvillim të mjedisit rural, dhe me atë edhe vetë tre komunave.

Secila komunë është bartës kryesor i zhvillimit ekonomik, që nuk mund të realizohet vetëm me të punësuarit, por duhet të përfshihen edhe potencialet njerëzore të komunitetit afarist, organizatave afariste, shoqatave qytetare, komuniteteve fetare, kulturës, sportit, shëndetësisë, arsimit dhe vetëqeverisjes lokale, me anë të njohurive të tyre, shkathtësive, kapitali, prona dhe infrastruktura për krijimin e kushteve më të volitshme për një sistem të vetë qëndrueshëm ekonomik. Duke marrë parasysh faktin për gjendjen me resurset njerëzore dhe kualifikimi i tyre, ky shoqërim, duket e nevojshme për të rritur potencialin e konkurrencës. Përveç kësaj, me anë të sigurimit të përparësisë konkurruese, GKL-ja do të sigurojë profil personal, ndërsa secila komunë do të sigurojë që dallohet nga komunat fqinje dhe ajo kontribuon për krijimin e kushteve autentike për zhvillim. Pikërisht kjo llojllojshmëri mund të kontribuojë për zhvillimin e territorit të plotë.

Ky dokument i shkurtë, në bazë të dokumenteve strategjike dhe zbulimeve të GLA "ABER 2015" është përfshirë territori, përmbledh fushat kryesore në të cilat duhen intervenime me qëllim të arrihet konkurrencë më të mirë dhe zhvillim të qëndrueshëm.



АБЕР 2015

Здружение за рурален развој Локална Акциона Група АБЕР 2015

ZBULIME KRYESORE

Në përputhje me metodologjitë dhe kategorizimet e rajoneve rurale dhe vendbanimeve, territori e GLA-së është rurale, me përjashtim të qytetit të Kumanovës. Hapësira e komunave Likovë, Staro Nagoriçane dhe Kumanovë paraqesin një territor që ka elemente relative kohezive në aspekt të gjeografisë, relievit, klimës dhe dheut si dhe në aspekt të vlerave të krijuara: shenjat sociale-kulturore dhe tradita, ekonomia dhe lidhja komunikuese. Kjo lidhje jep mundësi që kjo të trajtohet si një mjedis i veçantë rurale mbi të cilat mund të zbatohen metodologji për zhvillim të bazuar në rajon, si dhe vetë metodologjia LEADER. Karakteristike për territorin është që ka një migracion mjaft të shprehur, duke shikuar në kuadër të gjithë Rajonit Juglindor të Planifikimit, që është mjaft e shprehur gjatë dekadës së fundit. Faktorët social dhe ekonomik, papunësia e popullatës lokale janë shkaqet kryesore për këtë dukuri.

Grupi Lokal i Aksionit “ABER 2015” i përcakton politikat zhvillimore në Planin Strategjik për Zhvillim Lokal të rajonit rural në të cilin funksionon. Plani strategjik është dokumenti themelor zhvillimor që sistematizon dhe bashkon politikat zhvillimore, dhe njëherë shërben si instrument drejtues. Plani strategjik ishte krijuar në punëtori në periudhën 2014-2015 dhe ishte miratuar me para-adaptim të planit në përputhje me Planin për Përmbajtjen dhe Metodologjinë për përgatitje të Strategjive për Zhvillim Lokal të Rajoneve Rurale dhe mënyrën e aprovimit të tyre (Gazeta Zyrtare e RM-së, 40/2013) në Kuvendin e Dytë të GLA ABER 2015 të zhvilluar më 26 maj 2017.

Plani strategjik ka për qëllim të përcaktojë mekanizma dhe të identifikojë dhe sigurojë resurse me të cilat do të përfshijë gjithë faktorët relevant në zhvillimin e territorit të tyre. Strategjia bazohet në vendosjen e partneriteteve efektive me sektorin publik, privat dhe atë qytetar. Procesi i plotë përfshirës i planifikimit strategjik ka mundësuar që të përcaktohen vizioni dhe qëllimet strategjike, të grupuar sipas fushave vijuese të intervenimit: bujqësi dhe ekonomi rurale, turizëm, mjedis jetësor dhe cilësi të jetës në komunitetet rurale. Në procesin e hartimit të Strategjisë, gjithashtu, ishin marrë parasysh edhe gjitha dokumentet aktuale relevante në nivelin lokal, rajonal dhe kombëtar.

SWOT analiza e Strategjisë ka ndarë zbulimet vijuese si bazë për përmirësimin e konkurrencës së prodhimtarisë lokale dhe zhvillimit të qëndrueshëm, në lidhje me anët e fuqishme dhe mundësitë: 1) mikro-rajoni Likovë – Kumanovë – Staro Nagoriçane ka një infrastrukturë të zhvilluar primare (Korridorin 8-10), 2) burime të pasura natyrore - ujëra gjeotermale dhe lokacione kulturore-historike (Kokino, Bislim, Matejç, Liqeni i Likovës, kisha, manastire, xhami, vende arkeologjike, lokaliteti Vizianos, etj.), 4) histori dhe traditë dhe 5) rajon të populluar (resurse njerëzore) me popullatë prej 137.382 banorë. Në anët e fuqishme përfshihen edhe 6) prania e industrisë bujqësore, këpucëtaria dhe industria e tekstitit, 7) qendra e trajnimit në Staro Nagoriçane, 8) rajoni është në kufi (me Serbinë, Kosovën dhe Bullgarinë), 9) ka mjedis të pastër, 10) potencial për zhvillim të bujqësisë, 11) përvoja paraprake me simulimin e LEADER dhe kapacitete të zhvilluara për cikël projektues – resurse njerëzore, si dhe shumë dokumente strategjike në nivelin lokal dhe rajonal. Për anë të dobëta dhe kërcënime, në këtë dokument janë dhënë drejtime dhe rekomandime përkatëse.



АБЕР 2015

Здружение за рурален развој Локална Акциона Група АБЕР 2015

DREJTME DHE REKOMANDIME

- Duhet investime në **infrastrukturën arsimore**: modernizim i sistemeve arsimore siç janë kompjuterizimi dhe programe të reja mësimore; hapje të programeve mësimore në shkollat e mesme që do të kontribuonin për rritje të përparësive ekonomike në fokusin e GLA-së për blegtori, turizëm rural dhe hotelieri; hapja e studimeve të disperzuara në arsimin e lartë në fushën e administratës afariste dhe gjuhë angleze për përforsim të kapaciteteve të administratës lokale dhe bizneseve lokale private.
- Zhvillimi i **infrastrukturës rrugore**: ndërtimi i rrugës ekspres në drejtim të Bullgarisë dhe hapje të më tepër rrugëve – lidhës në mjediset rurale. Me këtë do të nxitet zhvillimi i turizmit dhe rritet vizita e kapaciteteve turistike, dhe do të mundësohet ngritja e kapaciteteve nga industria e lehtë dhe që nuk ndot.
- Prioritet infrastrukturor për këtë GLA është ndërtimi i **rrjetit fshat-fshat**. Me përmirësimin e këtij rrejt rajonet rurale do të mundësohet rritje të shkëmbimit tregtar dhe me atë të mundësohet që kapitali i vogël të mbetet në mjediset rurale. Gjithashtu, potencialet turistike, ato natyrore dhe antropogjenë, do të përdoren më mirë ndërsa të ardhurat do të jenë më mirë të shpërndarë, gjegjësisht bizneset private do të kenë mundësi dhe konkurrencë të barabartë.
- Rritje të kapacitetit të **kalimeve kufitare** me Kosovën dhe Serbinë, janë fusha prioritare që pushteti lokal duhet të prezantojë dhe llobojë në nivelin qendror.
- **Infrastruktura energjetike** që është përfaqësuar në Komunën e Kumanovës përdoret shumë pak. Përveç tre kompanive, gazi natyror që arrin nga Rusia nuk përdoret. Për momentin ka paralajmërime për gazifikim të qytetit të Kumanovës që rekomandohet të ndërtohet pasi që të përmirësohet standardi i jetës së popullatës. Ka mundësi edhe për gazifikim të vendeve rurale. Përveç përmirësim të kushteve jetësore, me këtë do të mundësohet edhe ruajtje të mjedisit jetësor.
- **Infrastruktura komunale** është në masë të madhe një problem. Mbeturinat e forta që për momentin hidhet në mikro-deponi të paligjshme paraqet një problem afatgjatë. Ky problem planifikohet të rregullohet me ndërtimin e deponisë rajonale që do të shërbejë rajonin më të gjerë. Prioritet për këtë rajon është ndërtimi i stacioneve të pastrimit për ujërat e zeza në mjediset rurale. Për momentin, këto ujëra derdhen në gropa septike me të cilat ndoten ujërat. Rrjeti primar i kanalizimit është prioritet për gjitha rajonet rurale në GLA.
- Territori i GLA-së ka bazë të mirë për **zhvillim të bujqësisë**. Duhet të arsimohet kuadër teknik në këtë fushë që do të kontribuojë për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve dhe standardeve për punë. Në nivelin lokal duhet të bëhen tentime për mbushje të parcelave me të mbjella dhe kultura si dhe të mikro-fermave, proces që për momentin e udhëheq pushteti qendror.
- Njëherë, duhet të përmendet që popullata ka nevojë për **ngritje të kapaciteteve në bujqësi** me çfarë do të bëhen më konkurrentë në tregun e brendshëm dhe të huaj. Përveç know-how,



АБЕР 2015

Здружение за рурален развој Локална Акциона Група АБЕР 2015

duhet të mbushet edhe pronësia e parcelave të punueshme tek fermat e vogla familjare me qëllim që të përballojnë shtypjen ekomomike nga fermat më të mëdha dhe kapaciteteve industriale.

- Gjithashtu, duhet të shqyrtohet edhe mundësia e mirëmbajtjes së të mbjellave dhe kulturave, që janë në vendet rurale, me përdorimin e metodave dhe praktikave të **prodhimtarisë organike**.
- **Bletaria** në rajonin ka potencial të rritet në degë serioze industriale që për momentin është vetëm një okupacion familjar. Natyra dhe distanca e industrive ndotëse mundësojnë një trend rritës dhe të papenguar në këtë degë industriale.
- **Resurset e ujit** nuk janë aspak të përdorur për qëllime komerciale përveç disa restoranteve përreth Liqenit të Likovës. Ujërat gjeotermale dhe minerale ofrojnë mundësi për fitim të mirë por edhe mundësi të rritura për vetëpunësim, me anë të zhvillimit të turizmit të banjave. Ujërat termale gjithashtu mund të përdoren për ngrohjen e serave dhe fermave por edhe me përdorimin e teknikave më të ndërlikuar mund të shpërndahen edhe në shtëpitë dhe kapaciteteve turistike.
- Rekomandohet që komunat të mundësojnë **kushte më të mira për investim nga ana e punëtorëve të përkohshme** në ndërmarrjet mikro dhe të vogla. Një sektor mjaft i volitshëm me përparësi krahasuese është zhvillim rural.
- Gjithashtu, në rajon ka resurse natyrore që përdoren në **industrinë ndërtimore**. Në momentin ka kushte të volitshme për koncesione dhe investime në miniera. Përveç mineraleve, ky mikro-rajon duhet më tepër të investojë në nxjerrjen e rërës dhe thëngjillit që ka shumë dhe ofron mundësi për punësim të shumë personave.



АБЕР 2015

Здружение за рурален развој Локална Акциона Група АБЕР 2015

KONKLUZION

Transformimi i territorit të GLA "ABER 2015" në një mjedis me cilësi të rritur të jetës që është e themeluar dhe funksionon në mënyrë efikase dhe ekonomi fleksibile, si dhe shërbime sociale-kulturore të siguruar, nuk mund të arrihet pa investime në përmirësimin e institucioneve, infrastrukturës, resurset njerëzore dhe potencialet arsimore, vendosja e standardeve të larta për cilësi dhe krijim i mundësive më të shumta dhe kushte të barabarta për pjesëmarrje të personave dhe subjektet ligjore në vendimmarrjen e përbashkët të politikave zhvillimore dhe ndarje të përgjegjësisë për zhvillim mes gjithë pjesëmarrësve. Ky transformim duhet të zbatohet me anë të një drejtimi të organizuar, koordinuar dhe integruar të aktiviteteve dhe me përfshirjen e gjitha subjekteve-palëve të interesuara në përpjekjet zhvillimore për koordinim të aktiviteteve dhe ndarje të përgjegjësisë gjatë realizimit të masave zhvillimore. Gjatë kësaj, transformimi duhet të zbatohet në drejtim të rritjes së mëtutjeshme të GLA-së me anë të krijimit të mundësive për investim, ulje të dallimeve në kapacitetet e aktorëve, largimi i dobësive të identifikuar të brendshëm në kuadër të GLA-së dhe mobilizimi i anëve të fuqishme të mundësive aktuale.

Janë të nevojshme intervenime të koordinuar në kuptim të arsimit, infrastrukturës rrugore, komunale dhe energjetike, nxitje të modernizimit dhe konkurrencës në bujqësi dhe investimeve të përgjithshme të zhvillimit rural.

Këto masa të organizuara dhe aktivitete do të rezultojnë që GLA-ja të kontribuojë për një rajon më të zhvilluar rural në të cilin janë krijuar ushte për jetë me cilësi të lartë, në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe aktorëve tjerë të GLA-së.

BURIMET

Plani Strategjik për Zhvillim Rural i Grupit Lokal të Aksionit "Aber" (2015-2020)

Strategjia për Zhvillim Lokal të Rajonit Rural të Komunave Likovë, Kumanovë dhe Staro Nagoriçanë, <http://kumanovo.gov.mk/wp-content/uploads/2017/1.-Стратегија-АБЕР-2015.pdf>

INFORMACIONE PLOTËSUESE

Shoqata për Zhvillim Rural GLA ABER 2015

Dragan Çungurski

Tel: 075 434 900

e-posta: dchungurski@gmail.com

Elisabeta Cvetkovska

Tel: 070 236 999

e-posta: elisabeta3@yahoo.com

Dejan Gjorgjievski

Tel:s 075 290 936